

VENDIM
Nr. 241, datë 18.5.2000

PËR RIORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ÇMIMEVE TË
BARNAVE

(Ndryshuar me VKM nr. 368, datë 11.6.2004)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 44 dhe 45 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994, "Për barnat", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Riorganizimin e Komisionit të Çmimeve të Barnave pranë Ministrisë së Shëndetësisë, i cili të përbëhet nga kryetari dhe 8 anëtarë përfaqësues nga:*

- Ministria e Shëndetësisë *kryetari dhe 2*
anëtarë;

- Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor *2 anëtarë;*

- Ministria e Financave *1 anëtar;*

- Shoqata e Grosistëve Farmaceutikë *1 anëtar;*

- Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë *1 anëtar;*

- Shoqata e Konsumatorëve të Shqipërisë *1 anëtar.*

2. Drejtoria Farmaceutike e Ministrisë së Shëndetësisë mbledh dhe përpunon informacionin për çmimet e barnave të fabrikuara në vend dhe ato të importuara dhe ia përcjell Komisionit të Çmimeve të Barnave. Ky i fundit ngarkon Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për hartimin e projektit të çmimeve referencë. Mosdhënia e informacionit për çmimet e barnave shoqërohet me sanksione ndaj fabrikuesve apo importuesve, të parashikuara në ligj.

2/1. ISKSH-ja mbledh dhe përpunon çmimet e barnave që rimbursohen, të cilat ia paraqet Komisionit të Çmimeve të Barnave.

3. Komisioni i Çmimeve të Barnave mbi bazën e listës së barnave që rimbursohen nga Sigurimet Shëndetësore dhe të çmimeve referencë të paraqitura nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor diskuton projektin, negocion për çmimet e paraqitura dhe i propozon Këshillit të Ministrave për miratim strukturën e çmimeve brenda tremujorit të parë të çdo viti.

4. Çmimet e miratuara të barnave që rimbursohen nga sigurimet shëndetësore janë të vlefshme për një vit. Ndryshimi i tyre nuk mund të bëhet më shpesh se një herë në gjashtë muaj dhe vetëm kur kushtet ekonomike të fabrikuesve vendas apo të huaj ndryshojnë, apo kur ndryshon përbërja e listës së barnave që rimbursohen nga Sigurimet Shëndetësore, mbi bazën e informacionit të hollësishëm të paraqitur nga fabrikuesit Komisionit të Çmimeve të Barnave. Çdo ndryshim i çmimeve do të miratohet me të njëjtën procedurë. Fabrikuesit vendas apo të huaj apo importuesit do të njoftohen si për nevojat për informacion shtesë ashtu dhe për vendimin e mosndryshimit të çmimit.

5. Komisioni i Çmimeve të Barnave organizon studimin e marzheve të fabrikimit dhe tregtimit dhe i propozon Këshillit të Ministrave për caktimin e tyre.

6. Çdo anëtar i Komisionit të Çmimeve të Barnave shpërblehet me 2 000 lekë nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se një herë në muaj.

7. Vendimi nr. 311, datë 6.5.1996, si dhe paragrafi 2 i pikës 1 dhe pika e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 13.1.1997 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Illir Meta